

UDHËZIM
Nr. 19, datë 12.6.2015

PËR POROSITJEN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E TEKSTEVE
SHKOLLORE PËR KLASAT II-V DHE VII-XII PËR VITIN SHKOLLOR 2015-2016

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 47 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010 “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. POROSITJA E TEKSTEVE PËR VITIN SHKOLLOR 2015-2016

1. Për vitin shkollor 2015-2016, katalogu i teksteve shkollore për klasat II-V dhe VII-XII, bashkëlidhur këtij udhëzimi, të përbëhet nga tekstet shkollore më cilësore të përzgjedhura nga mbi 10% e të gjithë mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

2. Porositja e teksteve të bëhet mbi bazën e përzgjedhjes së realizuar sipas udhëzimit të ministrit të MAS nr. 9, datë 26.3.2015 “Për përzgjedhjen e teksteve shkollore më cilësore për vitin shkollor 2015-2016”.

3. Shkollat që kanë përzgjedhur tekste shkollore që nuk janë pjesë e katalogut bashkëlidhur këtij udhëzimi, të ripërzgjedhin, në bazë shkolle, tekste shkollore nga ky katalog, sipas udhëzimit të ministrit të MAS nr. 9, datë 26.3.2015 “Për përzgjedhjen e teksteve shkollore më cilësore për vitin shkollor 2015-2016”.

4. Drejtori i shkollës, brenda datës 17 qershor 2015, të porosisë tekstet zyrtarisht në çdo shtëpi botuese/distributor, duke përcjellë një kopje origjinale të tabelës përmbledhëse me titujt dhe sasinë e teksteve shkollore.

5. Drejtori i shkollës të dërgojë në DAR/ZA, brenda datës 22 qershor 2015, tabelën përmbledhëse me titujt dhe sasinë e teksteve të poro-situra nga shkollla.

6. Drejtorët e shkollave të pakicave kombëtare dhe të arsimit profesional t'i dërgojnë shtëpisë botuese BOTEEM, brenda datës 17 qershor 2015, porosinë e tyre për tekstet shkollore me një alternativë, ku të shënojnë saktësisht numrin e nxënësve të tyre.

7. Dokumentacioni që rrjedh nga zbatimi i këtij udhëzimi, të ruhet në arkivin e shkollës për dy vjet dhe të jetë objekt i kontrollit të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit dhe të MAS-it.

II. SHPËRNDARJA DHE SHITJA E TEKSTEVE SHKOLLORE

1. Botuesit /distributorët janë përgjegjës për shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore.

2. Shitja e teksteve shkollore të bëhet nga njësitë tregtare të shitjes së librave. Çdo shkollë, për periudhën 25 gusht -13 shtator 2015, u vë në dispozicion falas personave të ngarkuar nga shpërndarësit e rrethit (librashitësit), një ose dy klasa të sigurta për shitjen e teksteve shkollore me hologramën e MAS-it.

3. Ndalohet shpërndarja dhe shitja e teksteve shkollore nga punonjës arsimorë, me përjashtim të shkollave të arsimit profesional dhe të pakicave kombëtare, ku shpërndarja dhe shitja e tekstit shkollor mund të bëhet nga punonjës arsimorë të ngarkuar nga DAR/ZA-ja dhe nga drejtoritë e këtyre shkollave.

4. Përgjegjësi i sektorit të kurrikulës në DAR /përgjegjësi i sektorit të kualifikimit dhe cilësisë në ZA është personi përgjegjës (pikë kontakti), që mban lidhje të vazhdueshme me MAS-in dhe informon për mbarëvajtjen e procesit.

5. Subjekteve të licencuara për shitjen e teksteve shkollore nuk u lejohet të shesin në shkollë libra

që nuk u përkasin katalogut të teksteve shkollore bashkëlidhur.

6. DAR/ZA-te, gjatë dy javëve para fillimit të vitit të ri shkollor dhe një javë pas tij, të raportojnë në MAS çdo ditë, në mënyrë të vazhdueshme, për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore.

7. ISHA, pas monitorimit të procesit të shpërndarjes dhe të shitjes së teksteve shkollore, t'i raportojë me shkrim ministrit të Arsimit dhe Sportit.

III. ZBATIMI DHE HYRJA NË FUQI

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale, zyrat arsimore, shkollat dhe mësuesit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE I SPORTIT

Lindita Nikolla